



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 17.07.2019
Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN “PËR MBROJTJEN CIVILE”

- ***Hyrje***

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi në mbledhjet e datës 15.07.2019 16.07.2019 dhe në parim, nen për nen dhe në tërësi, projektligjin “Për mbrojtjen civile”.

Për të prezantuar projektligjin në komision ishin të pranishëm:

1. Z. Petro KOÇI, Zëvendësministër i Mbrojtjes
2. Z. Haki CAKO, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile (DPEC)
3. Z. Ismail SHEHU, Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standartizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, në Ministrinë e Mbrojtjes
4. Z. Maksimiljan DHIMA, Drejtor i Planifikimit dhe Koordinimit, pranë DPEC
5. Znj. Albana AGASTRA (Qehajaj), Këshilltare për mediat

Relator i projektligjit u caktua deputeti Sadi Vorpsi.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji është në përputhje të plotë me Kushtetutën, në harmoni me legjislacionin vendas, si dhe në linjë me kuadrin “Sendai” për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, më datë 3.6.2015.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit***

Legjislacioni aktual në fuqi në fushën e emergjencave civile paraqet një sërë mangësish, të cilat ndikojnë në të gjithë ciklin e menaxhimit të emergjencave civile parandalim-gadishmëri-përgjigje-rimëkëmbje.

Gjithashtu ligji aktual nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, i ndryshuar, i cili ka hedhur baza kryesisht në fushën e planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile, nuk ka asnjë përcaktim për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, sikurse ka mangësi thelbësore në shumë përcaktime të tij për fusha, siç janë: paralajmërimi i hershëm, edukimi, trajnimi, asistenca ndërkombëtare, monitorimi, njoftimi, alarmi dhe inspektimi.

Edhe përcaktimet e tij për institucionet dhe strukturat qendrore dhe ato vendore sikurse strukturat operationale të cilat janë përbërëse të sistemit të mbrojtjes civile janë evidentuar prej vitesh që janë sa të cekëta aq edhe të pamjaftueshme për kohën.

Ndërhyrja është e nevojshme me qëllim integrimin e prioriteteve, qëllimeve dhe objektivave të Kuadrit Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive, në politikat e qeverisjes në të gjitha nivelet, veçanërisht nëpërmjet hartimit dhe implementimit të Strategjisë Kombëtare dhe strategjive vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, vlerësimeve të riskut nga fatkeqësitë dhe planeve të emergjencave civile në nivelin qendror, qarku dhe vendor, si dhe masave të tjera.

Janë disa direktiva dhe vendime të BE-së me rëndësi të veçantë në fushën e zvogëlimin të riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjen civile të cilat kanë nevojë për përafrim.

Projektligji ka si qëllim zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe realizimin e mbrojtjes civile për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, të pronës, të gjësë së gjallë, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, nëpërmjet forcimit të sistemit të mbrojtjes civile. Sipas këtij projektligji, mbrojtja civile ka si mision krijimin e kushteve për një shoqëri të aftë për të përballuar fatkeqësitë e ndryshme dhe për t’u rimëkëmbur, nëpërmjet ngritjes së një sistemi të integruar dhe efikas të mbrojtjes civile në Republikën e Shqipërisë.

Projektligji rregullon funksionimin e sistemit të mbrojtjes civile, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë e institucioneve dhe të strukturave të këtij sistemi, bashkëpunimin ndërkombëtar, të drejtat dhe detyrimet e shtetasve dhe të subjekteve private, edukimin, trajnimin dhe inspektimin.

Ky projektligj do të sigurojë përshtatjen e sistemit të mbrojtjes civile me standardet evropiane, në përputhje edhe me prioritetet e kuadrit “Sendai” për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë.

Objektivat e këtij projektligji janë, si më poshtë vijon:

- a) Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë, nëpërmjet identifikimit të saktë, vlerësimit periodik të riskut dhe monitorimit të tij, duke zbutur pasojat negative të fatkeqësive, duke investuar në parandalimin e risqeve, duke intensifikuar bashkëpunimin e të gjitha subjekteve të këtij ligji, si dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet tyre, nëpërmjet parashikimit të masave, në funksion të realizimit të tij.
- b) Forcimi i sistemit të mbrojtjes civile, nëpërmjet krijimit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC), si person juridik, publik, qendror në varësi të ministrit

përgjegjës për mbrojtjen civile, që përgjigjet për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. AKMC-ja do të jetë autoriteti më i lartë koordinues, bashkërendues, drejtues, teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile. AKMC-ja do të organizohet si drejtori e përgjithshme në nivel qendror, ndërsa në nivel vendor organizohet në bazë qarku, sipas qendrave të mbrojtjes civile.

c) Forcimi i kapaciteteve administrative, teknike dhe financiare të sistemit të mbrojtjes civile në tërësinë e tij, nëpërmjet përcaktimit më qartë të rolit dhe përgjegjësisë të të gjithë aktorëve të këtij sistemi, në nivel qendror, në nivel qarku dhe në nivel vendor.

ç) Integrimi i prioriteteve, i qëllimeve dhe i objektivave të kuadrit “Sendai” për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive, në politikat e qeverisjes në të gjitha nivelet, veçanërisht nëpërmjet hartimit dhe implementimit të Strategjisë Kombëtare dhe strategjive vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, vlerësimeve të riskut nga fatkeqësitë dhe planeve të emergjencave civile në nivel qendror, në nivel qarku dhe në nivel vendor, si dhe masave të tjera.

d) Përmirësimi i edukimit për mbrojtjen civile në shkolla, nëpërmjet përfshirjes së lëndëve përkatëse arsimore në nivelin arsimor parauniversitar.

dh) Mirëfunksionimi i sistemit të paralajmërimit të hershëm, i monitorimit, njoftimit dhe alarmit, duke përcaktuar detyrat për institucionet përgjegjëse dhe subjektet private, të përfshirë në të.

e) Parashikimi i rregullave më të qarta të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe atij ndërinstitutional në kuadër të asistencës ndërkombëtare dhe të procedurave përkatëse.

ë) Rritja e rolit ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, nëpërmjet rolit më të madh dhe më aktiv të saj dhe përmbushjes së kontributeve në BE, NATO, OKB, OSBE etj.

f) Bërja e çështjes së zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë në një çështje të secilit sikurse të të gjithë shoqërisë. Kjo do të arrihet, ndër të tjera, nëpërmjet rritjes së rolit të të gjithë aktorëve shtetërorë, individëve dhe subjekteve private në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile dhe nëpërmjet përcaktimit të të drejtave e detyrave që ato kanë në këtë fushë.

g) Planifikimi dhe realizimi sa më cilësor i masave strukturore dhe jostrukturore në fushën e zvogëlimit të riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjes civile, me theks të veçantë te masat parandaluese nga fatkeqësitë dhe atyre rehabilituese në infrastrukturë.

gj) Zbatimi më i mirë i detyrave dhe i përgjegjësisë të të gjithë aktorëve të sistemit të mbrojtjes civile, nëpërmjet sanksionimit të kundërvajtjeve administrative, zbatimi i të cilave do të kontrollohet nëpërmjet inspektimit që do të kryhet nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

- ***Vlerësimi i shkallës së përafrimit me acquis të BE-së***

Ky ligj synon përafrim me acquis të Bashkimit Evropian, si më poshtë:

- – Direktivën e Këshillit 2008/114/KE, datë 8.12.2008, “Për identifikimin dhe përcaktimin e infrastrukturave kritike evropiane dhe vlerësimin e nevojës për të

- përmirësuar mbrojtjen e tyre”. Numri CELEX 32008L0114, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr.345, datë 23.12.2008, fq.75-82;
- Direktivën 2007/60/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 23 Tetor 2007 “Për vlerësimin dhe menaxhimin e rriskut të përmbytjeve”. Numri CELEX 32007L0060, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr.288, datë 6.11.2007, fq. 27-34.
 - Direktivën 2012/18/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 4.7.2012, “Mbi kontrollin e rreziqeve të aksidenteve të mëdha që përfshijnë substanca të rrezikshme, që ndryshon dhe më pas shfuqizon Direktivën e Këshillit 96/82/KE”. Numri CELEX 32012L0018, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr.197, datë 24.7.2012, fq.1-37.
 - Direktivën 2002/22/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 7.3.2002 “Mbi shërbimin universal dhe të drejtat e përdoruesve në lidhje me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike” e ndryshuar” (Direktiva e Shërbimit Universal). Numri CELEX 32002L0022, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr.108, datë 24.4.2002, fq.51-77;
 - Vendimin Nr. 1313/2013/BE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 17.12.2013 “Mbi mekanizmin e mbrojtjes civile të Bashkimit Europian”, i ndryshuar”. Numri CELEX 32013D1313, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr.347, datë 20.12.2013, fq.924–947.
 - Vendimin zbatues të Komisionit 2014/762/BE, datë 16.10.2014, që përcakton rregullat për zbatimin e vendimit nr.1313/2013/BE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit “Mbi mekanizmin e mbrojtjes civile të Bashkimit Europian” dhe që shfuqizon Vendimet e Komisionit 2004/277/KE, Euroatom dhe 2007/606/KE, Euroatom”, i ndryshuar. Numri CELEX 32014D0762, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr.320, datë 6.11.2014, fq.1–45.

• *Diskutimi në komision*

- ✚ Në fjalën e tij, Z.Koçi u shpreh se projektligji reformon një sektor shumë të rëndësishëm sepse ka të bëjë me garatimin e sigurisë së qytetarëve shqiptarë dhe shënon fillimin e një transformimi të madh në qasjen e shtetit shqiptar ndaj çështjeve të emergjencave e mbrojtjes civile në tërësi.

Gjatë periudhës rreth 1 vjeçare e gjysmë të funksionimit të strukturës së emergjencave civile në Ministrinë e Mbrojtjes, konstatuam se nevoja për kryerjen e një reforme të thellë ligjore, strukturore dhe organizative në këtë sektor ishte imediate dhe që duhet të fillonte që me hartimin e një ligji të ri “Për mbrojtjen civile”, që do të zëvendësonte ligjin “Për emergjencat civile” të vitit 2001.

Ai parashtroi disa nga risitë kryesore që sjell ky projektligj ku pjesa absolutisht më e rëndësishme është se projektligji sjell një revolucion në qasjen tonë ndaj emergjencave duke e zhvendosur fokusin nga reagimi, tek parandalimi dhe zvogëlimi i riskut.

E vërteta është se gjatë dekadave të fundit, ka pasur një shpërfillje e mungesë përgjegjësie të plotë ndaj parandalimit, ndaj parapërgatitjes apo zvogëlimit të riskut. Ndërkohë që lidhur me reagimin ka pasur herë pas here nisma pozitive, sidomos gjatë

viteve të fundit, kur edhe falë mbështetjes së aleatëve janë rritur kapacitetet reaguese, nuk është bërë thujtë asgjë për të ndërtuar një mekanizëm të ri për përballimin e emergjencave, i cili të vendoste theksin tek zvogëlimi i riskut.

Është e vështirë ta shpjegosh këtë mungesë përgjegjshmërie, pasi koncepti i zvogëlimit të riskut shërben si boshti i organizimit të mbrojtjes civile në shumë vende të botës, e sidomos në vendet anëtare të NATO, qysh në fillimin e viteve 1990. Për më tepër, siç mund t'ju thotë çdo specialist e çdo raport ndërkombëtar, Shqipëria është një nga 10 vendet e para në botë për sa i përket riskut të lartë ekonomik ku 86% e territorit, ku prodhohet 88.5% e PBB, është e ekspozuar ndaj dy ose më shumë rreziqeve. Apo, siç thotë raporti i Riskut Botëror i 2016 – që duhet thënë që ishte një kampanë alarmi për të gjithë ne – për sa i përket indeksit të riskut nga fatkeqësitë natyrore Shqipëria renditet si vendi më i rrezikuar në Europë dhe i 40 në botë.

E sigurisht, këtyre kërcënimeve ju duhen shtuar edhe ato që burojnë sot nga ndryshimet klimatike pasojat e të cilave i hasim edhe ne. Mjafton të kujtojmë këtu sesi kanë ndryshuar ekstremet e temperaturave, me ngricat në periudhën e dimrit dhe temperaturat ekstreme gjatë muajve të verës apo situatat e reshjeve dhe rrezikun e përmbytjeve që ato sjellin. Ne nuk mund të mjaftohemi më duke reaguar ndaj emergjencave pasi ato ndodhin sepse një qasje e tillë është thjesht e paqëndrueshme dhe e papërbalueshme.

Projektligji për “Mbrojtjen Civile”, sjell një ndryshim vërtet të rëndësishëm pikërisht në këtë drejtim. Nga sot, krahas fuqizimit të kapaciteteve reaguese, fillon edhe puna për të zvogëluar riskun me të cilin përballet vendi ynë dhe qytetarët. Është një qasje identike me atë që zbatohet tashmë prej kohësh në mjekësi, ku çdo mjek mund t'ju thotë që parandalimi është jo vetëm shumë më efikas, por edhe me kosto më të ulët, sesa reagimi ndaj sëmundjes dhe adresimi i pasojave.

Ajo që vlen për t'u theksuar po ashtu është fakti që duke miratuar këtë ligj Shqipëria përmbush edhe parametrat e Kuadrit Sendai për Reduktimin e Riskut dhe të Fatkeqësive 2015 – 2030 të miratuar nga OKB. Dhe i hap rrugë më në fund anëtarësimit të Shqipërisë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile Evropiane/UCPM, që është një mekanizëm bashkëpunimi dhe koordinimi për reagimin ndaj fatkeqësive në Europë e më gjerë. Është një fakt i papranueshëm që sot në të gjithë rajonin tonë vetëm Shqipëria, Kosova dhe Bosnja-Hercegovina mbeten ende jashtë këtij mekanizmi si pasojë e neglizhencës për të reformuar këtë sektor gjatë dekadave të fundit.

Zbatimi i këtij ligji, ndërtimi i mekanizmit që ai parashikon, kërkon shumë punë dhe shumë angazhim nga një sërë institucionesh.

Kërkon po ashtu shumë më tepër koordinim ndër-institucional, më shumë kapacitete dhe më shumë fleksibilitet në adresimin e çështjeve të zvogëlimit të riskut dhe mbrojtjes civile, çka nuk mund të arrihet përmes strukturës aktuale. Prandaj një nga risitë themelore që sjell projektligji – ky është në fakt një nga rekomandimet kryesore edhe të aleatëve, sidomos atyre amerikanë që dëshiroj t'i falënderoj për mbështetjen e tyre – pra, një nga risitë themelore të ligjit është transformimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile e cila do të jetë një strukturë e përhershme ndër-institucionale e nivelit të lartë, me shumë më tepër autoritet, me kapacitete shumë më të mëdha administrative, teknike dhe financiare krahasuar me ato aktuale, përgjegjësi dhe kompetenca më të gjera të krahasueshme edhe me të gjitha strukturat homologe.

Mandej Z.Koçi theksoi se projektligj reflekton edhe gjetjet e rekomandimet e disa raporteve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes civile, ku do të veçoja:

- Raportin e Komandës Amerikane në Evropë, korrik 2014;
- Raportin e vlerësimit të Ekipit të Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian/ UCPM, të hartuar pas përmbytjeve të shkurtit 2015;
- Raportin “Vlerësimi i Nevojave pas Fatkeqësisë” pas përmbytjeve të shkurtit 2015, të asistuar nga OKB, Banka Botërore dhe Bashkimi Evropian.
- Si dhe Raportet e progresit të viteve të fundit të Komisionit Evropian për Shqipërinë.

Emëruesi i përbashkët i këtyre raporteve është nevoja për fokusimin tek politikat e reduktimit të riskut dhe zhvendosjen e fokusit nga menaxhimi i fatkeqësive tek menaxhimi i risqeve të tyre.

Por eksperiencia jonë me menaxhimin e emergjencave na ndërgjegjësoi edhe për një tjetër aspekt shumë të rëndësishëm të problemit që lidhet me nevojën për një ndarje të qartë të përgjegjësisë të çdo aktori institucional. E veçanërisht nga njësitë e qeverisjes vendore të cilat deri më sot kanë neglizhuar në masë të madhe respektimin e parimit të subsidiaritetit edhe pse ky parim është sanksionuar me ligj që në vitin 2015.

Nisur nga këto dy konstatime e rekomandime kryesore, disa nga risitë e projektligjit janë si më poshtë:

- Projektligji përcakton Strategjinë Kombëtare për Reduktimin e Riskut të Fatkeqësive si dokumentin bazë strategjik të RSH-së në menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë çka është në mënyrë eksplicite reflektimi i gjetjeve të përvitshme të Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë por edhe vetë objektivi i pestë i Kuadrit Sendai.
- Projektligji vendos tavane të qarta për përqindjen e buxhetit për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjen civile në 2-4% në ministritë e linjës dhe 4% e buxhetit tek bashkitë.
- Projektligji sanksionon detyrimin për hartimin e Strategjisë të Zvogëlimit të Riskut të Fatkeqësive në çdo NJQV.
- Sanksionon detyrimin për përgatitjen e dokumentit të vlerësimit të riskut dhe planeve të emergjencave civile në nivelin qendror, të prefekturës dhe të bashkisë.
- Ndan qartë detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve, të subjekteve private, organizatave dhe shoqatave të shoqërisë civile, të shtetasve në tërësi dhe detyrimet specifike që lidhen me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, të parashikuara në përputhje me Kuadrin Sendai.
- I kushton vëmendje të posaçme mbrojtjes së infrastrukturës kritike dhe trashëgimisë kulturore. Dhe këtu duhet theksuar që Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë dhe Plani për Emergjencat Civile, janë të detyrueshme edhe për infrastrukturën kritike.
- Bën të detyrueshme Planet për Emergjencat Civile për institucionet shtetërore dhe subjektet private në sektorët e shëndetësisë, arsimit, mirëqenies sociale, kulturës, mjedisit dhe turizmit sikurse për subjektet që prodhojnë dhe magazinonë materiale të rrezikshme, karburante dhe derivate të tyre, gazra energjetike, si dhe kryejnë veprimtari me mjete të rrezikshme.

- Përmban sanksione të qarta për të gjitha institucionet publike, subjektet private, sikurse përcakton qartë edhe funksionimin e mekanizmit të inspektimit;
- Rrit në mënyrë thelbësore rolin e prefektit të qarkut dhe NJVV-ve në Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive dhe Mbrojtjen Civile;
- Mundësohet krijimi i Bazës së të dhënave të Fatkeqësive në tre nivelet sikurse sanksionohet detyrimi i vlerësimit të dëmeve të fatkeqësive nga ministritë dhe bashkitë.

Në mbydhje të fjalës së tij, Z.Koçi u shpreh se ky ligj është një hap vërtet i rëndësishëm, por është vetëm një hap i parë drejt ngritjes së një mekanizmi shumë kompleks për mbrojtjen e qytetarëve shqiptarë, jetës dhe pronës së tyre. Do të duhet shumë punë. Disa nga pjesët më të rëndësishme siç janë edukimi i fëmijëve për mjedisin e emergjencat apo promovimi i vullnetarizmit do të duan shumë kohë. Por ama, nëse kemi mësuar një gjë deri më sot është që nuk mund të vazhdojmë më me zgjidhje afatshkurtra e ad hoc sa për të kaluar lumin vetëm për të vrapuar pastaj drejt krizës apo emergjencës së radhës.

 Relatori i projektligjit, Z.Vorpsi u shpreh parimisht dakort me projektligjin duke vënë edhe njëherë theksin tek rëndësia e tij dhe objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet tij.

Ai theksoi se legjislacioni aktual në fuqi në fushën e emergjencave civile, paraqet një sërë mangësish, të cilat ndikojnë në të gjithë ciklin e menaxhimit të emergjencave civile parandalim-gadishmëri-përgjigje-rimëkëmbje.

Gjithashtu ligji aktual nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, i ndryshuar, i cili ka hedhur baza kryesisht në fushën e planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile, nuk ka asnjë përcaktim për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, sikurse ka mangësi thelbësore në shumë përcaktime të tij për fusha, si paralajmërimi i hershëm, edukimi, trajnimi, asistenca ndërkombëtare, monitorimi, njoftimi, alarmi dhe inspektimi.

Edhe përcaktimet e tij për institucionet dhe strukturat qendrore dhe ato vendore, sikurse strukturat operationale të cilat janë përbërëse të sistemit të mbrojtjes civile, janë evidentuar prej vitesh që janë sa të cekëta aq edhe të pamjaftueshme për kohën.

Në mënyrë të veçantë kjo bazë ligjore është krejtësisht e vjetëruar pasi nuk pasqyron aspak politikat e pranuar ndërkombëtarisht të zvogëlimin të riskut të fatkeqësive por edhe politika të tjera të lidhura ngushtësisht me to siç janë Axfenda për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030, Marrëveshja e Parisit mbi ndryshimin e klimës dhe Axfenda e Re Urbane. Gjithashtu, në stadin aktual nuk është bërë ende implementimi në të gjithë vendin i numrit të thirrjeve pa pagesë 112, si numri i vetëm evropian i thirrjeve emergjente.

Mandej Z.Vorpsi, u shpreh se ndërhyrja është e nevojshme me qëllim integrimin e prioriteteve, qëllimeve dhe objektivave të Kuadrit Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive, në politikat e qeverisjes në të gjitha nivelet, veçanërisht nëpërmjet hartimit

dhe implementimit të Strategjisë Kombëtare dhe strategjive vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, vlerësimeve të riskut nga fatkeqësitë dhe planeve të emergjencave civile në nivelin qendror, qarku dhe vendor, si dhe masave të tjera. Janë disa direktiva dhe vendime të BE-së me rëndësi të veçantë në fushën e zvogëlimin të riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjen civile të cilat kanë nevojë për përafrim.

Më pas Z.Vorpsi, renditi objektivat dhe efektet që synohen të arrihen nëpërmjet kësaj nisme të cilat janë si më poshtë:

- Të zvogëlohet risku nga fatkeqësitë, nëpërmjet identifikimit të saktë, vlerësimit periodik të riskut dhe monitorimit të tij, duke zbutur pasojat negative të fatkeqësive, duke investuar në parandalimin e risqeve, duke intensifikuar bashkëpunimin e të gjithë subjekteve të këtij ligji, si dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet tyre, nëpërmjet parashikimit të masave, në funksion të realizimit të tij.
- Të forcohet sistemi i mbrojtjes civile nëpërmjet krijimit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC).
- Të forcohen kapacitetet administrative, teknike dhe financiare të sistemit të mbrojtjes civile në tërësinë e tij, nëpërmjet përcaktimit më qartë të rolit dhe përgjegjësive të të gjithë aktorëve të këtij sistemi, në nivel qendror, qarku dhe vendor.
- Të përmirësohet edukimi për mbrojtjen civile në shkolla, nëpërmjet përfshirjes së lëndëve përkatëse arsimore në nivelin arsimor parauniversitar.
- Të parashikohen rregulla më të qarta të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe atij ndërinstitutional në kuadër të asistencës ndërkombëtare dhe procedurave përkatëse.
- Të rritet roli ndërkombëtar i Republikës së Shqipërisë në fushën e zvogëlimin të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, nëpërmjet rolit më të madh dhe më aktiv të saj dhe përmbushjes së kontributeve në BE, NATO, OKB, OSBE etj.

Në mbyllje të fjalës së tij z.Vorpsi tha se projektligji do të sigurojë bazën ligjore për një model të ri jo vetëm për menaxhimin e fatkeqësive, por edhe për vendosjen e koncepteve moderne, gjithëpërfshirëse dhe në përputhje me terminologjinë evropiane dhe botërore, duke synuar zbatimin më efektiv të masave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, do të mundësojë arritjen e objektivave ligjore si dhe do të kontribuojë në integrimin e Shqipërisë në BE.

Anëtarët e Komisionit të Sigurisë u shprehën dakort në parim me projektligjin dhe vijuan diskutimet dhe pyetjet në çështjet që lidhen me risitë e projektligjit; bashkëpunimi me institucionet ligjzbatuese, cilat janë shkaqet që çuan në ndryshimin e emrit dhe shndërrimin e DPEC-së në agjenci, nëse me këtë projektligj ka ndryshime në strukturën organike, shtabet e mbrojtjes civile, çështjet lidhur me përgjegjësitë që sipas projektligjit u ngarkohen organeve të qeverisjes vendore etj. Gjithashtu u përgëzua fakti i ndarjes së një pjese të buxhetit, posaçërisht për emergjencat civile në masën prej 4% etj.

Gjithashtu, gjatë diskutimit nën për nën anëtarët e komisionit u ndalën në çështje më konkrete në funksion të përmirësimit të këtyre dispozitave.

- **Riformulime nen për nen**

Komisioni për Sigurinë Kombëtare bazuar në çështjet e parashtruara si dhe nga diskutimi nen për nen i projektligjit si dhe nisur nga sugjerimet e komisionit për çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut si dhe Komisionit për integrimin European, si komision përgjegjës, propozon riformulimet si më poshtë:

Projektligji duhet të rishikohet nga ana gjuhësore dhe seksionet të numërtohen me numra romakë.

Tabelat e përputhshmërisë që shoqërojnë projektligjin duhet të korrigjohen pasi nuk janë plotësuar sipas kriterëve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për instrumentat e përafrimit të legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së (Neni 17, pika 2 dhe 3 të ligjit Nr.15/2015).

Ndryshimet e propozuara nga Komisioni për Integrimin European, të reflektohen në tabelat finale të përputhshmërisë.

- **Neni 3, pika 16 e projektligjit**, të riformulohet si më poshtë:

“16. “Infrastrukturë kritike me efekt ndërkufitar”, ajo infrastrukturë kritike, ndërprerja ose shkatërrimi i së cilës do të kishte impakt të rëndësishëm në një ose disa shtete kufitare me Republikën e Shqipërisë. Rëndësia e impaktit duhet të vlerësohet sipas kriterëve ndërsektoriale. Këtu përfshihen efektet që rezultojnë nga varësitë ndërsektoriale në llojet e tjera të infrastrukturës.”

- **Neni 8, gërma “ç”, fjala “inkurajuar”** të zëvendësohet me fjalën “nxitur” duke u riformuluar si më poshtë:

“ç) investimin në parandalimin dhe zvogëlimin e risqeve nga fatkeqësitë, duke nxitur investimet publike e private dhe ndërmarrjen e masave strukturore dhe jostrukturore;”

- **Neni 10, pika 2 e projektligjit**, pas fjalës “vjet” shtohet togfjalëshi “nga Këshilli Ministrave me propozim të ministrit ” duke u riformuluar si më poshtë:

2.Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë rishikohet jo më pak se një herë në çdo pesë vjet, nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit.”

- **Neni 13 i projektligjit:**

- **Pika 6**, pas fjalës “gjykatë” shtohet togfjalëshi “administrative kompetente” duke u riformuluar si më poshtë:

“6.Ndaj vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit ose të kryetarit të bashkisë bëhet ankim i drejtpërdrejtë në gjykatën administrative kompetente, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e lëshimit të vërtetimit’.

- **Pika 7**, fjala “përcaktohen” zëvendësohet me fjalën “miratohen” duke u riformuluar si më poshtë:

“7.Procedura dhe afatet e pajisjes me vërtetim mbi riskun miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

- **Neni 18 i projektligjit, gërma “d”**, pas togfjalëshit “të Republikës së Shqipërisë” shtohet togfjalëshi “nëpërmjet ministrit përgjegjës” dhe fjala “pëlqimin” zëvendësohet me fjalën “miratimin” duke u riformuluar si më poshtë:

“ d)Informon Kuvendin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet ministrit përgjegjës për situatën e krijuar, rreziqet që paraqiten dhe masat e marra për menaxhimin e situatës, si dhe kërkon miratimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë përtej 30 (tridhjetë) ditëve”

- **Neni 20 i projektligjit, pika 2**, fjala “Kryeministrit” zëvendësohet me togfjalëshin “Këshillit të Ministrave” duke u riformuluar si më poshtë:

“2.Zyra përgjegjëse për situatën është strukturë pranë Kryeministrit për mbledhjen e informacionit për emergjencat civile, krizat dhe hartimin e raporteve analitike periodike për Kryeministrin, Këshillin e Ministrave dhe KMC-në, si dhe mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe strukturave të tjera të ngarkuara me funksione të emergjencave civile dhe krizave”.

- **Neni 22 i projektligjit:**

- **Pika 2, gërma “b”**, pas fjalës “energjetikën” shtohet fjala “arsimin” duke u riformuluar si më poshtë:

“ b) Planifikojnë buxhet vjetor për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile sipas fushës së përgjegjësisë së tyre shtetërore. Për ministritë përgjegjëse për mbrojtjen civile, mbrojtjen, punët e brendshme, transportin, infrastrukturën, bujqësinë, shëndetësinë, energjetikën, arsimin, mjedisin dhe kulturën, planifikimi buxhetor duhet të jetë nga 2% deri në 4% e totalit të buxhetit vjetor”

- **Pika 2, gërma “ç”** afati 3 vjet bëhet 2 vjet duke u riformuluar si më poshtë:

“ ç) Brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, krijojnë bazën e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë në fushën e përgjegjësisë së tyre, të cilën e mirëmbajnë, e përditësojnë, si dhe shkëmbejnë informacione me AKMC-në”

- **Në pikën 3**, pas gërmës “ë” shtohet gërma “f” me këtë përmbajtje:

“f) ministria përgjegjëse për arsimin merr çdo masë për vijimin pa ndërprerje të procesit arsimor”.

- **Neni 23 i projektligjit:**

- **Pika 6 gërma “ë”**, pas fjalës “qendrës” shtohet fjala “kombëtare” dhe riformulohet si më poshtë:

“ë) Nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Trajnimeve për Mbrojtjen Civile kryen trajnimet e strukturave shtetërore, të subjekteve private e vullnetare.

- **Pika 6 gërma “g”**, pas togfjalëshit “subjekteve të tjera juridike” shtohet togfjalëshi “brenda dhe jashtë vendit” duke u riformuluar si më poshtë:

“g) Lidh marrëveshje me organizata jofitimprurëse ose subjekte të tjera juridike brenda dhe jashtë vendit, në lidhje me mbrojtjen civile,.

- **Neni 25 i projektligjit:**

- **Pika 1** riformulohet si më poshtë:

1. Në ministrinë përgjegjëse për mbrojtjen civile, nën drejtimin e AKMC-së, krijohet dhe funksionon komisioni teknik këshillimor, i cili këshillon për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive.

- **Pika 3**, fjala “përcaktohen” zëvendësohet me fjalën “miratohen” duke u riformuluar si më poshtë:

“3. Detyrat, përbërja dhe funksionimi i këtij komisioni miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

- **Neni 26 i projektligjit, pika 2**, fjala “përcaktohen” zëvendësohet me fjalën “miratohen” duke u riformuluar si më poshtë:

“2. Përbërja, detyrat dhe funksionet e qendrave të mbrojtjes civile në qark miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

- **Neni 28 i projektligjit:**

- **Pika 2, gërma “a”** të riformulohet si më poshtë :

“ a) Të kthejë buxhetin e vitit pasardhës të bashkive brenda territorit administrativ të tij, në rast se nuk janë planifikuar fondet buxhetore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile sipas parashikimeve të nenit 65 të këtij ligji.

- **Pika 2, gërma “b”**, afati “3 vjet” zëvendësohet me afatin “2 vjet” duke u riformuluar si më poshtë:

“b) Brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, kryen vlerësimin e risqeve në territorin e qarkut përkatës, duke hartuar dhe miratuar dokumentin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel qarku, i cili i dërgohet Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për qëllim analizimi dhe planifikimi;

- **Pika 2, gërma “gj”**, afati “3 vjet” zëvendësohet me afatin “2 vjet” duke u riformuluar si më poshtë:

“gj) Brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji krijon bazën e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë në nivel qarku, të cilën e mirëmban dhe e përditëson, si edhe shkëmben informacione me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe, sipas rastit, me prefektët e qarqeve fqinje;

- **Pika 2, gërma “l”**, fjala “monitoron” zëvendësohet me fjalën “kontrollon” duke u riformuluar si më poshtë:

“l) Kontrollon zbatimin e masave të marra nga bashkitë e qarkut për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile”

- **Neni 29 i projektligjit, pika 3**, fjala “përcaktohen” zëvendësohet me fjalën “miratohen” duke u riformuluar si më poshtë:

“3. Përbërja, funksionimi dhe detyrat e komisioneve, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij neni, miratohen me urdhër të prefektit/kryetarit të bashkisë”.

- **Neni 30 i projektligjit:**

- **Gërma “a”**, afati “3 vjet” zëvendësohet me afatin “2 vjet” duke u riformuluar si më poshtë:

“a) Brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, kryejnë vlerësimin e risqeve në territorin e tyre, duke hartuar dhe miratuar dokumentin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë, të cilin ia dërgojnë prefektit të qarkut dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, për qëllime analizimi dhe planifikimi;

- **Gërma “ë”** afati “3 vjet” zëvendësohet me afatin “2 vjet” duke u riformuluar si më poshtë:

“ë) Brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, krijojnë bazën e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë për territorin e bashkisë, të cilën e mirëmbajnë dhe e përditësojnë, si edhe shkëmbejnë informacione me prefektin e qarkut dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile;

- **Gërma “gj”**, hiqet fjala “të ndryshme” duke u riformuluar si më poshtë:

“gj) Kryejnë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi në territorin e tyre, vlerësimin e nevojave për përballimin e tyre, si dhe dëmshpërblejnë shtetasit për fatkeqësitë e ndodhura në territorin e tyre”

- **Gërma “i”**, fjala “akumulojnë” zëvendësohet me fjalën “mbledhin” duke u riformuluar si më poshtë:

“i) Mbledhin në gatishmëri sistemet e mbrojtjes nga zjarri, kalueshmërinë e pandërprerë të rrugëve rurale, vendet e strehimit, si dhe mbledhin dhe administrojnë rezervat ushqimore për njerëzit dhe gjënë e gjallë”.

- **Neni 35 i projektligjit, pika 2**, fjala “të vdekurit” zëvendësohet me fjalën “viktimize” duke u riformuluar si më poshtë:

“2. Detyrat e saj përfshijnë mbrojtjen e zonës së emergjencës civile, ruajtjen e rendit publik, procesin e identifikimit dhe të informimit rreth të dëmtuarve dhe viktimave, largimin e tyre nga zona e emergjencës, si dhe detyra të tjera që dalin në zbatim të legjislacionit në fuqi për Policinë e Shtetit”.

- **Neni 38 i projektligjit, pika 3**, fjala “përcaktohen” zëvendësohet me fjalën “miratohen” duke u riformuluar si më poshtë:

“3. Trajtimi i vullnetarëve për angazhimin e tyre në aktivitete të mbrojtjes civile apo në operacionet e parandalimit dhe të përballimit të fatkeqësive miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit”.

- **Neni 39 i projektligjit, pika 2**, fjala “pëlqimin” zëvendësohet me fjalën “miratimin” duke u riformuluar si më poshtë:

“2. Zgjatja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, sipas përcaktimit të bërë në pikën 1, të këtij neni, mund të bëhet vetëm me miratimin e Kuvendit”.

- **Neni 40 i projektligjit:**

- **Pika 1** riformulohet si më poshtë:

“Emergjencat civile kategorizohen në:

a) emergjenca civile vendore, që vijnë si pasojë e fatkeqësive që ndodhin në një bashki dhe mund të përballohen me anë të veprimeve të strukturave kompetente të saj;

b) emergjenca civile rajonale, që vijnë si pasojë e fatkeqësive që ndodhin në më shumë se një bashki, që për shkak të natyrës, shkallës dhe shtrirjes së tyre, kërkojnë ndërhyrjen e koordinuar të disa bashkive ose qarqeve;

c) emergjenca civile kombëtare, që vijnë si pasojë e fatkeqësive që për shkak të intensitetit, të shkallës dhe të shtrirjes së tyre kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme të të gjitha institucioneve të mbrojtjes civile, qendrore e vendore, edhe me masa të jashtëzakonshme, nëse është e nevojshme”.

- **Pika 3**, fjala “përcaktohen” zëvendësohet me fjalën “miratohen” duke u riformuluar si më poshtë:

“3. Kriteret dhe procedurat për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit”.

• **Neni 41 i projektligjit:**

- **Pika 4**, hiqet fjala “mund” duke u riformuluar si më poshtë:

“4. Në rast se vlera e kompensimit tejkalon 8% të buxhetit të bashkisë, KMC-ja vendos që kompensimi të kryhet nga AKMC-ja”.

- **Pika 6**, fjala “përcaktohen” zëvendësohet me fjalën “miratohen” duke u riformuluar si më poshtë:

“6. Masa e kompensimit të dëmeve, procedurat, afatet, strukturat shtetërore përgjegjëse për vlerësimin e dëmeve, si dhe pasuritë dhe subjektet që kompensohen miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

• **Neni 42 i projektligjit, pika 1, gërma “a”,** fjala “ndërmarrjen” zëvendësohet me fjalën “marrjen” duke u riformuluar si më poshtë:

“a) marrjen e masave organizative dhe administrative për përballimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”

• **Neni 43 i projektligjit, pika 2, gërma “b”,** fjala “dërgojnë” zëvendësohet me fjalën “paraqesin” duke u riformuluar si më poshtë:

“b) hartojnë dhe përditësojnë dokumentin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë, si edhe planin për emergjencat civile, të cilat i paraqesin në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për qëllime planifikimi dhe analizimi”.

• **Neni 45 i projektligjit,** hiqet fjala “të ndryshme” duke u riformuluar si më poshtë:

“Çdo objekt që është pjesë e tërësisë së vlerave të trashëgimisë kulturore e historike, të luajtshme apo të paluajtshme, gjatë fatkeqësive gëzon mbrojtje nga shteti në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi trashëgiminë kulturore”.

• **Neni 47 i projektligjit, pika 3,** fjala “përcaktohen” zëvendësohet me fjalën “miratohen” duke u riformuluar si më poshtë:

“3.Ngritja dhe funksionimi i sistemit të numrit të unifikuar të thirrjeve emergjente 112 miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me bashkëpropozim të ministrit përgjegjës për emergjencat civile dhe të ministrit përgjegjës për punët e brendshme”.

- **Neni 49 i projektligjit, pika 1,** hiqet fjala “të ndryshme” duke u riformuluar si më poshtë:

“1.Institucionet publike dhe strukturat qendrore dhe vendore, të përcaktuara në këtë ligj, informojnë publikun për fatkeqësitë dhe masat për përballimin e tyre”.

- **Neni 50 i projektligjit, pika 4,** fjala “përcaktohen” zëvendësohet me fjalën “miratohen” duke u riformuluar si më poshtë:

“4.Llojet e sinjaleve të alarmit, numri dhe mënyra e përdorimit të tyre, në rastet e fatkeqësive, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit”.

- **Neni 51 i projektligjit, pika 3,** fjala “përcaktohen” zëvendësohet me fjalën “miratohen” duke u riformuluar si më poshtë:

“3.Kriteret për identifikimin e subjekteve private, strukturat përgjegjëse për identifikimin e tyre, si dhe rregullat për realizimin e bashkëpunimit ndërmjet tyre, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit”.

- **Neni 52 i projektligjit, pika 1, gërma “a”,** fjala “zbulimeve” zëvendësohet me togfjalëshin “kërkimeve dhe gjetjeve” duke u riformuluar si më poshtë:

“1.Institucionet e arsimit të lartë, institucionet kërkimore-shkencore, entet e ndryshme publike e private, si dhe organizatat e tjera të angazhuara në punë kërkimore e shkencore:

a)njoftojnë Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile rreth kërkimeve dhe gjetjeve shkencore në lidhje me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile”.

- **Neni 55 i projektligjit, pika 1,** pas fjalës “të lehtësuara” shtohet togfjalëshi “sipas legjislacionit në fuqi” duke u riformuluar si më poshtë:

“1.Kalimi i kufirit shtetëror nga ekipet vendase apo të huaja, si dhe logjistikës së tyre, në kuadër të asistencës ndërkombëtare për parandalimin dhe përballimin e fatkeqësive, kryhet me procedura të përshtetshme dhe të lehtësuara sipas legjislacionit në fuqi”.
(sugjerim i Komisionit të Ligjeve e cila është marrë parasysh)

- **Neni 56 i projektligjit, pika 3** të riformulohet si më poshtë:

“3.Në operacionet e mbrojtjes dhe të shpëtimit në vendet e tjera dërgohen vetëm persona të aftë dhe të trajnuar, të cilët kanë pranuar me shkrim pjesëmarrjen. Modulet që përbëhen vetëm nga burimet shtetërore ose ato të përbashkëta me shtete të tjera, grupet e mbështetjes dhe të asistencës teknike, kapacitetet e tjera të përgjigjes dhe ekspertët e tyre, si dhe ekipet që do të marrin pjesë në asistencën ndërkombëtare, duhet të deklarohen dhe regjistrohen në një kohë sa më të shkurtër në Kapacitetin e Mbrojtjes Civile Evropiane”.

- **Neni 59 i projektligjit,** hiqet togfjalëshi “kategoritë e mëposhtme” duke u riformuluar si më poshtë:

Përfshihen nga detyrimi për t’u angazhuar në operacione për parandalimin dhe përballimin e fatkeqësive:

- a) Personat me aftësi të kufizuara dhe personat që kujdesen për ta;*
- b) Personat me probleme shëndetësore;*

- c) Gratë shtatzëna, nënat me fëmijë nën 10 vjeç dhe prindërit e vetëm me fëmijë nën moshën 15 vjeç;
- ç) Personat nën 18 dhe mbi 65 vjeç.

- **Neni 60 i projektligjit, pika 1**, togfjalëshi “të përhershëm dhe të përditësuar” të zëvendësohet me fjalën “të vijuar” duke u riformuluar si më poshtë:

“1.Subjektet private kanë të drejtë të informohen në mënyrë të vijuar për risqet nga fatkeqësitë, si dhe për masat e nevojshme dhe ato të marra për menaxhimin e tyre”.

- **Neni 61 i projektligjit, pika 1**, riformulohet si më poshtë:

1.Subjektet private vendase dhe të huaja, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, kanë këto detyra:

- a) Të hartojnë dhe të përditësojnë plane të brendshme për emergjencat civile të harmonizuara me planet e jashtme për emergjencat civile të bashkisë, apo bashkive dhe qarkut apo qarqeve, si edhe rregullore të brendshme sipas rrezikshmërisë së proceseve teknologjike, kur ato përdorin, prodhojnë dhe magazinonë materiale të rrezikshme, karburante dhe derivate të tyre, gaze energjetike, si dhe kryejnë veprimtari me mjete të rrezikshme,;
- b) Të sigurojnë me shpenzimet e tyre pajisjet e alarmit për punonjësit e tyre dhe për komunitetin, si dhe të garantojnë funksionimin e tyre, kur ato kanë mbi 20 punëmarrës;
- c) Të informojnë punonjësit e tyre për rreziqet e mundshme, t’u sigurojnë atyre kushte dhe mundësi për realizimin e mbrojtjes së tyre;
- ç) Të njoftojnë dhe të japin alarmin për komunitetin e rrezikuar dhe të njoftojnë tek numri i unifikuar i thirrjeve emergjente 112, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, numrat e tjerë të emergjencave, apo edhe autoritetet e tjera sipas ligjit, në rastet e fatkeqësive;
- d) Të sigurojnë trajnimin për punonjësit e tyre, për parandalimin dhe përballimin e fatkeqësive, kur ato kanë mbi 20 punëmarrës;
- dh) Të bashkëpunojnë me strukturat e mbrojtjes civile dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore ku ata ushtrojnë veprimtarinë e tyre;
- e) Të aktivizojnë shërbimin në përgjigje të situatës së krijuar nga fatkeqësia në këtë zonë dhe në ndihmë të subjekteve të tjera;
- ë) Të vendosin në dispozicion të strukturave të mbrojtjes civile automjete, mjete, mjedise private, objekte, pajisje dhe burime energjetike, sipas kërkesës së strukturave të mbrojtjes civile;
- f) Të vendosin pa pagesë, në dispozicion të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe të njërive të vetëqeverisjes vendore, të dhënat që ato disponojnë dhe që janë të nevojshme për përgatitjen e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë dhe planit për emergjencat civile.

- **Neni 64 i projektligjit, pika 1, gërma “b”**, të riformulohet si më poshtë:

“1.Buxheti i mbrojtjes civile të institucioneve qendrore përbëhet nga:

- b) buxheti vjetor i çdo ministrie, i parashikuar si zë më vete, për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjen civile”.*

- **Neni 65 i projektligjit:**

- **Pika 1** riformulohet si më poshtë:

1. Bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji mbështeten në parashikimin minimal prej 4 për qind të totalit të buxhetit vjetor të tyre, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit.

- **Shtohet pika 2** me këtë përmbajtje:

2. Bashkitë mund të planifikojnë fonde të tjera shtesë nga burimet financiare, si më poshtë vijon:

- a) Nga të ardhurat e veta vendore;
- b) Nga fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet;
- c) Si dhe burime të tjera të parashikuara në ligj.

- **Pika 2, e cila kalon si pikë 3**, fjala “përcaktohen” zëvendësohet me fjalën “miratohen” duke u riformuluar si më poshtë:

“3. Procedurat dhe kriteret e ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

• **Neni 68 i projektligjit, pika 1**, të riformulohet si më poshtë:

“1. Shkelja e njëres prej dispozitave të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “ç” dhe “d”, të pikës 1, dhe shkronjat “a” e “b”, të pikës 2, të nenit 61, të këtij ligji, nga subjektet private, kur nuk përbën vepër penale përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) - 100 000 (njëqind mijë) lekë”.

• **Neni 69 i projektligjit, pika 2**, fjala “përcaktohen” zëvendësohet me fjalën “miratohen” si dhe togfjalëshi “me urdhër të ministrit” zëvendësohet me togfjalëshin “të Drejtorit të Përgjithshëm të AKMC-së” duke u riformuluar si më poshtë:

“2. Mënyra e konstatimit dhe e shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative realizohen në bazë të legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative, ndërkohë që formati i procesverbalit të konstatimit të shkeljes miratohet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AKMC-së”.

• **Neni 70 i projektligjit, pika 2**, fjala “përcaktohen” zëvendësohet me fjalën “miratohen” duke u riformuluar si më poshtë:

“2. Përbërja e Komisionit dhe procedura e shqyrtimit miratohen me urdhër të ministrit”.

• **Neni 72 i projektligjit** ndryshohet si më poshtë:

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që:

- a) brenda 2 (dy) vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 9 pika 3, nenit 10 pika 1, nenit 14 pika 4, neni 22 pika 4, neni 23 pikat 2 dhe 6 shkronja “d”, nenit 38 pika 3, nenit 40 pika 3, nenit 47 pika 3, nenit 48 pika 2, nenit 50 pika 4 dhe nenit 51 pika 3 të këtij ligji.
- b) brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 20 pika 3, nenit 25 pika 3, nenit 26 pika 2, nenit 41 pika 6, dhe nenit 65 pika 2 të këtij ligji.

- c) brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 13 pika 7 dhe 23 pika 7 të këtij ligji.
2. Ngarkohet ministri përgjegjës për mbrojtjen civile që, brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 23 pika 9 dhe 70 pika 2, të këtij ligji.
3. Ngarkohen prefektët e qarqeve që, brenda 3 (tre) vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të neneve 14 pika 5, 28 pika 2, shkronja “gj”, dhe 29 pika 3, të këtij ligji.
4. Ngarkohen këshillat bashkiakë që, brenda 3 (tre) vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të neneve 11, 14 pika 6, dhe 30 shkronja “a”, të këtij ligji.
5. Ngarkohen kryetarët e bashkive që, brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin aktin nënligjor në zbatim të nenit 29 pika 3, të këtij ligji.

- **Neni 73 i projektligjit, pika 1**, fjala “trasformohet” zëvendësohet me fjalën “shndërrohet” duke u riformuluar si më poshtë:

“1.Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile shndërrohet në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, me hyrjen në fuqi të këtij ligj”.

- **Neni 75 i projektligjit**, riformulohet si më poshtë:

“Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe i shtrin efektet financiare duke filluar nga data 1.1.2020”.

• **Përfundim**

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje e miratoi atë duke vlerësuar se:

- **Në aspektin ligjor**, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.
- **Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Relator

Kryetar

Sadi VORPSI

Ermonela (Felaj) VALIKAJ